

Reagon edhe shoqëria civile

Tollovi të mëdha para QRA-së në Lipjan

Lipjan, 24 mars

Organizata Joqeveritare YAHR ka shprehur shqetësimin e qytetarëve të komunës së Lipjanit lidhur me pritjet e gjata që po ndodhin para Qendrës së Regjistrimit të Automjeteve (QRA) në Lipjan. Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR ka deklaruar se Ministria e Punëve të Brendshme (MPB-ja) ka dështuar në menaxhimin e situatës në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në komunën e Lipjanit, pas vendosjes së taksës për regjistrim me vonesë të automjeteve, pritjet e qytetarëve janë të gjatë para dyerve të kësaj qendre. “Po ashtu MPB-ja ka dështuar në trajnimin e stafit të kësaj qendre e cila për fat të keq të qytetarëve kjo qendër është hapur disa ditë para zbatimit të taksës për regjistrim me vonesë të automjeteve”, ka thënë ai. Ndërkohë që, Krasniqi është shprehur se gjysma e veturave që nuk ishin me afat skadence të regjistrimit u takonin zyrtarëve komunalë, policëve dhe politikanëve. “Është in-



teresante se në bazë të hulumtimeve tona mbi 50 për qind e strukturës së personave fizikë që nuk i kanë regjistruar automjetet dhe që tani po i regjistrojnë janë kryesisht zyrtarë

të institucioneve të ndryshme duke filluar nga policët, punëtorët nëpër administratën publike deri tek politikanët dhe militantet e partive politike”, ka thënë Krasniqi.